



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017

Ref.: 679/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit të BPrAL Kolegji AAB për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018:
 - Stomatologji, Dr. Dent , 360 ECTS, maksimumi 25 studentë për vit akademik;
- II. Obligohet Kolegji AAB, që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- III. Obligohet Kolegji AAB, që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegji AAB ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programit të studimit: Stomatologji, Dr. Dent , 360 ECTS, 60 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Stomatologji	Dr.Dent	360	Astrit Kuçi, Avdyl Shoshi, dhe Teuta Kutllovci

AKA ka organizuar vizitë në Kolegjin "AAB" më 26.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Ulrike Beier, Markus Paulmichl, Dietmar Paier, Bruce Brown, dhe Adrian Stan.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 28 Korrik 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegji AAB, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji AAB;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

